

REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA	
PARLAMENTI KOSOVAR	VLAZA • JOVA	GOVERNMENT OF KOSOVA	
SEKTORI I ARKIVËS	OFFICE OF THE PRIME MINISTER	ARCHIVE SECTOR	
Nr. Org. Org.Jedinst. Org. Unit	<u>02.3</u>	Nr. Prot: Dok. Prot: Prot. Nro:	<u>2534</u>
Nr. i fajave Br. stranica No. pages	<u>-PO-</u>	Data: Datum: Date:	<u>13/09/2019</u>
Prishtina/a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministratit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 11.09.2019
 Ref: 042/2019

Në mbështetje të pikës 4 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr 05/96 të datës 02.04.2019, për themelimin e Këshilli për bashkëpunimin të Qeverisë me Shoqërinë Civile, i themeluar për të promovuar dhe fuqizuar sektorin e shoqërisë civile dhe për të siguruar koordinimin dhe monitorimin e gjithë procesit të bashkëpunimi të qeverisë me shoqërinë civile, Këshilli në takimin e mbajtur më 17 korrik 2019 miraton:

Rregullat e Punës së Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile

I. Qëllimi

- Këto Rregulla të Punës i rregullojnë parimet kryesore, organizimin dhe mënyrën e punës së Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile (në tekstin e mëtejmë, Këshilli), të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit, përgatitjen dhe mënyrën e thirrjes së mbledhjeve, drejtimin e mbledhjeve dhe metodat e vendimmarrjes, grupet punuese të Këshillit, punën publike të Këshillit dhe mbështetjen administrative për punën e tij.
- Puna e Këshillit bazohet mbi parimet e partneritetit, bashkëpunimit, mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të të gjithë anëtarëve të Këshillit.
- Këto rregulla të punës vleinë për të gjithë Anëtarët e Këshillit, përfaqësues të Institucioneve të emëruar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/96, të datës 02 prill 2019 si dhe përfaqësues të OSHC-ve të emëruar me thirrje të hapur publike.

II. Detyrat e Këshillit

- Këshilli është mekanizmi kryesor i përhershëm, i cili do të koordinoj tërë procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile.

Këshilli është përgjegjës për zbatimin e detyrave në vijim:

- Koordinon procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile;
- Ofron opinione, këshilla dhe rekomandime për projekt aktet ligjore, dokumentet strategjike
dhe dokumentet e tjera që ndikojnë në punën dhe zhvillimin e OShC-ve;
- Inicion hartimin e legjisacionit dhe politikave publike me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të OShC-ve
- Propozon marrjen e masave për zbatimin e politikave publike që synojnë nxitjen e zhvillimit të OShC-ve,
- Diskuton dhe propozon zgjidhje për çështje të tjera që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile e që nuk janë të përcaktuara në Strategji;
- Monitoron zbatimin e Strategjisë, duke përfshirë:
 - përgjegjësinë për të ofruar këshilla mbi cilësinë e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mbi zbatimin e Strategjisë;
 - diskutimin dhe propozimin e zgjidhjeve për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Strategjisë
 - ofrimin e rekomandimeve për përditësimin e Planit Vjetor
 - Përgjegjësi për të rishikuar procesin e strategjisë
 - Propozimin e masave shtesë për zbatimin e Strategjisë.
- Ofron opinione dhe rekomandime për planet dhe raportet vjetore për shpërndarjen e fondeve publike në mbështetje të programeve dhe projekteve të OShC-ve.
- Ofron opinione dhe rekomandime për planet dhe raportet vjetore për konsultimet me publikun në politikë-bërje
- Merr parasysh propozimet, nismat dhe opinionet e paraqitura nga OShC-të për çështjet që janë kompetencat e këshillit;
- Miraton raportin vjetor të punës për vitin paraprak, ia dorëzon atë Qeverisë dhe e publikon në ueb faqe.
- Këshilli do të bashkëpunojë me institucionet e tjera publike si dhe me organizatat e shoqërisë civile për të zbatuar detyrat e veta.

III. Përbërja e Këshillit

- Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues nga shoqëria civile.
- Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, 14 prej tyre përzgjidhen nga vet organizatat e shoqërisë civile ndërsa bashkë kryesuesi emërohet nga Platforma CiviKos.
- Mandati i anëtarëve të Këshillit është katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Këshilli udhëhiqet nga:

- z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrat (Kryesues)
- znj.Donika Emini , Përfaqësuese e emëruar nga Platforma CiviKos (Bashkë Kryesues)
- z.Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrat, (zv.Kryesues)

Përfaqësuesit e tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës të ZKM:

- Ministria e Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Ministria e Integrimit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Ministria e Financave, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrat, Drejtori, një anëtarë
- Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrat, Drejtori, një anëtarë
- Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrat, Drejtori, një anëtarë
- Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtori, një anëtarë
- Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Drejtori, një anëtarë
- Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrat, Drejtori, një anëtarë.

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat shërben si Sekretariat i Këshillit dhe do të jetë në funksion për të zhvilluar dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.

Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve nga shoqëria civile menaxhohet nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat. Ky proces është i hapur, transparent dhe llogaridhënës duke marrë parasysh nevojën për të siguruar përfshirjen e spektrit të gjerë të interesave që përfaqësohen nga organizatat e shoqërisë civile.

IV. Organizimi i brendshëm i Këshillit

- Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë shërbyes civil të emëruar nga Qeveria dhe organet e tjera qeveritare dhe 15 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile të përzgjedhur nga organizata për thirrje publike e zbatuar nga CiviKos.
- Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi i Këshillit i cili është Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrat, Zëvendës kryesuesi i cili është Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Bashkë kryesuesi i emëruar nga Platforma CiviKos.
- Për të siguruar zbatimin e mandatit të Këshillit, për të ndihmuar punën e tij dhe për të qenë më efektiv në ushtrimin e rolit të tij, Këshilli do të themelojë nga një ekip pune për secilën prej katër Objektivave Strategjike;
- Katër (4) ekipe të punës do të krijohen për secilin Objektiv të Strategjisë;
- Ekipet e punës do të përfshijnë në përbërjen e tyre anëtarë të Këshillit, një përfaqësues të ZQM/ZKM, përfaqësues të institucioneve publike dhe OShC-ve të tjera, fushëveprimi i të cilave përputhet me objektivat përkatëse strategjike.
- Numri i anëtarëve të secilit ekip të punës sipas nevojës do të përcaktohet nga Këshilli në bashkërendim me të gjithë hisedarët e tjerë relevant.
- Një koordinator do të emërohet për secilin ekip punues i cili do të udhëheq dhe koordinojë punën e tij.

- Koordinatorët e ekipeve të punës do të jenë anëtarë të Këshillit;
- Këshilli do të shqyrtojë materialet, të dhënrat dhe propozimet e paraqitura nga ekipe dhe në parim iu përgjigjet të gjitha nismave të propozuara nga këto ekipe;
- Puna e ekipeve të punës do të zhvillohet në bashkërendim të plotë me ZQM/ZKM dhe CiviKos-in.
- Mbledhjet e ekipeve të punës do të thirren nga Sekretariati i Këshillit ose nga koordinatorët e ekipeve.
- Këshilli mund të krijoj edhe ekipe të punës me tematika tjera që ai i vlerëson të rëndësishme.

V. Kryesimi i Këshillit

Kryesuesi dhe bashkë kryesuesi:

- E përfaqësojnë dhe menaxhojnë punën e Këshillit;
- Thërrasin dhe i udhëheqin seancat e Këshillit;
- Nënshkruajnë aktet e miratuara nga Këshilli dhe kujdesen për zbatimin e tyre
- I udhëheqin aktivitetet e këshillit dhe anëtarëve të tij për promovimin e bashkëpunimit, dialogut dhe nxitjen e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile në Republikën e Kosovës;
- Propozojnë masa kur nuk zbatohen konkluzionet e Këshillit;
- Kujdesen për përgatitjen e planit vjetor për punën e Këshillit
- Informojnë publikun për punën e Këshillit
- Kryejnë aktivitete të tjera në pajtim me Rregullat e Punës.

Në rast të mungesës së Kryesuesit ai/ajo do të zëvendësohet nga Zëvendës kryesuesi i Këshillit. Zëvendës Kryesuesi do të ndihmojë Kryesuesin në punën e tij dhe do të përfaqësojë Këshillin për çështjet që i besohen atij nga Këshilli. Nëse Kryesuesi i Këshillit jep dorëheqje, Zëvendës Kryesuesi do të kryejë detyrat e Kryesuesit të Këshillit deri në zgjedhjen e një Kryesuesi të ri.

VI. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit

Të gjithë anëtarët e Këshillit do të kenë të drejta dhe obligime të njëjtë, si ata që janë të emëruar nga institucionet qeveritare apo ata që janë përzgjedhur nga organizatat e shoqërisë civile.

Anëtarët e Këshillit do të kenë të drejtë dhe obligim që të:

- Marrin pjesë në takimet dhe në punën e Këshillit;
- Propozojnë shqyrtimin e çështjeve nën kompetencat e Këshillit;
- Iniciojnë përmirësimë të metodave të punës së Këshillit;
- Marrin pjesë në zbatimin e detyrave dhe konkluzioneve shtesë që dalin për Këshillin bazuar në Rregulla e punës.
-

Anëtarët e Këshillit, që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në një takim të Këshillit, janë të obliguar, që përmes ZQM-së të lajmërojnë Këshillin paraprakisht dhe ta delegojnë një zëvendësim për pjesëmarrje në takimin e Këshillit, pa të drejtë vote.

Anëtarët e Këshillit që nuk mund të marrin pjesë në takim mund të dërgojnë opinionet, komentet dhe propozimet e tyre për materialet që do të diskutohen në Këshill para takimit.

VII. Përfundimi i mandatit për pjesëmarrjes në Këshill

- Anëtari i Këshillit mund të kërkojë të lirohet nga detyra e përfaqësuesit pjesëmarrjes në Këshill.
- Anëtari i Këshillit do të dorëzojë kërkesën për lirimin nga detyra e tij/saj me shkrim apo personalisht në takimin e Këshillit.
- Këshilli do të konfirmojë përfundimin e mandatit të anëtarit të Këshillit në ditën që mbahet takimi.
- Lirim i nga detyra gjithashtu bëhet për secilin anëtar të Këshillit i cili mungon për dy takime radhazi ose për më shumë se gjashtë muaj. Njoftimi për lirim nga detyra bëhet nga Kryesuesi ose Bashkë kryesuesi i Këshillit.
- Në rast të zëvendësimeve për anëtarët e Këshillit nga OJQ-të, procedurat e përzgjedhjes për përfaqësim në Këshill do të janë të njëjtë.
- Anëtarët e Këshillit nuk mund të përfaqësojnë një institucionin shtetëror dhe në të njëjtën kohë të përfaqësojnë një OJQ.

VIII. Takimet e Këshillit

- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrat i thërret takimet e Këshillit, pas konsultimit me kryesuesin dhe bashkë kryesuesin për: datën e takimit, rendin e ditës, materialet për diskutim dhe çfarëdo çështje tjeter që është e rëndësishme për përgatitjen e takimit.
- Krahas Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrat, mbledhjet e Këshillit mund të thirren edhe nga shumica e anëtarëve të Këshillit si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile anëtarë në Këshill.
- Këshilli mblidhet në takime së paku katër herë në vit për të vlerësuar përparimin, raportet dhe të gjitha çështjet që janë të përcaktuara sipas Rregullave të Punës.
- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrat ua dërgon anëtarëve të Këshillit ftesën për takim së bashku me rendin e ditës dhe materialet për diskutim të paktën shtatë ditë përpara takimit.
- Këshilli nuk mund t'i mbaj takimet pa qenë të pranishëm të paktën shtatë (7) prej anëtarëve të tij nga ana e institucioneve si dhe tetë (8) prej anëtarëve nga radhët e shoqërisë civile (gjegjësisht kuorumi 50% + 1).
- Anëtarët vëzhgues në takimet e Këshillit mund të ftohen me ftesë të përfaqësuesve të Këshillit, qoftë nga institucionet, qoftë nga organizatat e shoqërisë civile.
- Sekretariati i Këshillit sipas rekomandimeve të Këshillit obligohet që t'i ftojë në takim organizatat vendore apo partnerët ndërkombëtarë
- Angazhimi i anëtarëve të Këshillit, anëtarëve të ekipeve të punës dhe të tjerëve që përfshihen në punën e Këshillit bëhet në baza vullnetare, pa ndonjë kompensim financiar.

IX. Sekretariati i Këshillit

- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrat do të shërbejë si Sekretariat i Këshillit dhe do të jetë institucioni përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e punës së Këshillit.
- Për funksionimin e Këshillit të gjitha detyrat administrative dhe teknike do të kryhen nga ZQM/ZKM

- ZQM/ZKM publikon raportin mbi zbatimin e Planit të punës së Këshillit në baza vjetore.
- Krahas raporteve të përgatitura nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Këshilli do të merr në konsideratë dhe do të diskutojë raportet e tjera paralele të monitorimit të cilat mund të përgatiten nga Platforma CiviKos dhe OShC-të e tjera.
- Sekretariati do të mbështetet financiarisht nga Zyra e Kryeministrat dhe burimet njerëzore për avancimin me sukses të punës së Këshillit.

X. Procesverbalet e takimeve

- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrat do të përgatisë procesverbalet e çdo takimi të cilat do të aprovojen dhe nënshkruhen nga bashkë kryesuesit në takimin e radhës.
- Prosesverbali duhet t'i ketë të shkruara datën dhe vendin e mbajtjes së takimit, rendin e ditës, përbledhjen e diskutimeve, vendimet, emrat e anëtarëve pjesëmarrës dhe zëvendësve. Secili anëtarë i Këshillit do të ketë të drejtë që të kërkojë që diskutimi i tij/saj të jetë pjesë e takimit.
- Drafti i procesverbalit iu dërgohet anëtarëve të Këshillit, jo më vonë se dhjetë ditë pas seancës së Këshillit.

XI. Vendimmarrja

- Vendimmarrja në Këshill gjithmonë synohet të arrihet me konsensus.
- Në rast të mungesës së konsensusit vendimet hidhen në votim të hapur.
- Këshilli i merr vendimet me votën e shumicës së të gjithë anëtarëve të pranishëm në takimin e Këshillit.
- Në rastin e një vendimi me vota të barabarta, vota e bashkë kryesuesit, si përfaqësues i shoqërisë civile, është vendimtare.

XII. Transparenca e punës së Këshillit

- Takimet e Këshillit janë publike.
- Këshilli informon publikun për takimet dhe punën e Këshillit përmes mediave, në pajtim me rregulloret e brendshme të Qeverisë, publikimit të deklaratave për shtyp, prezantimit të raporteve, vendimeve të Këshillit dhe materialeve të tjera që shqyrtohen gjatë takimit të Këshillit.
- Në rrethana të jashtëzakonshme, Këshilli mund të vendos që të mbajtë myllur takimin pjesërisht apo tërësisht për publikun. Myllja e takimit për publikun vendoset me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
- Të gjitha aktivitetet e Këshillit do të publikohen në ueb faqen zyrtare të ZQM/ZKM-së.
- Në ueb faqe do të publikohen edhe ftesat, agjendat, procesverbalet dhe materialet për seancat e Këshillit.
- Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm, institucionet përgjegjëse raportojnë në mënyrë periodike për zbatimin e Planit të Veprimit i cili përditësohet çdo vit dhe publikohen në ueb faqe.

XIII. Ndryshimi i Rregullave të Punës

- Këshilli mund t'i ndryshojë Rregullat e punës me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit.



z. Fitim Krasniqi

Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministratit
Kryesues i Këshillit



znj. Donika Emini

Drejtoreshë Ekzekutive e CiviKos
Bashkë Kryesuese e Këshillit